

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reforma territoriale ndez debate PS-PD tek 'Ligjet', opozita kërkon futjen e draftit të saj në rend dite, Ma nja: Nuk e kam në tryezë, duhet të ndjekë procedurën! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/reforma-territoriale-ndez-debate-ps-pd-tek-ligjet-opozit-a-kerkon-futjen-e-draftit-te-saj-ne-rend-dite-manja-nuk-e-kam-ne-tryeze-duhet-te-ndjeke-proceduren/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 12:08:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 11:56:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	77443fc9daf9d2b260933b8d04dca86dd2880e159a2d5ea065d9d3270d3a2f1f
TEKSTI	41e1f4319207d3f415323a4e51bcbf7c879fe3f60a6095590e41bd0ce6c40565
PAMJA	8c4c540ceccced26c74da8197df574c9f7aa1d4b881f4e99c9777a7ae9af00a3a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	aaaa81d5f3ef5b16b5e30de3dcba21cee3c664a96cb7f3b2ea62382431529a0b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	37c1183d944b9abe724532469e5e873d69da6740426bb5bc7e8618c3c9fa36bf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/aaaa81d5f3ef5b16b5e30de3dcba21cee3c664a96cb7f3b2ea62382431529a0b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Politikë

Reforma territoriale ndez debate PS-PD tek ‘Ligjet’,
opozita kërkon futjen e draftit të saj në rend dite,
Manja: Nuk e kam në tryezë, duhet të ndjekë
procedurën!



Ervin Nikolla

28 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Debate dhe përplasje mes mazhorancës dhe opozitës shoqëruan sot diskutimet për reformën territoriale tek Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, ndërsa deputetët e opozitës kërkuar ndryshimin e rendit të ditës dhe shqyrtimin edhe të propozimit të tyre.

Deputeti Saimir Korreshi kundërshtoi bashkimin e bashkive, **duke ngritur shqetësimin për shërbimet** që, sipas tij, do të marrin qytetarët në bashki më të mëdha.

“

“Ne kemi plehrat mullar, ne jemi të mbaruar, ju doni të na bashkoni e të na bëni një. Po njerëzit, çfarë shërbimesh u ofroni? Do pyesë kryetari i bashkisë së madhe për fshatin e humbur? Bie roli specifik i qytetarit. Do presë dy orë për të mbajtur radhën. Ju nuk ofroni shërbim tani, jo po kur të jenë bashki më të mëdha”, tha Korreshi, duke propozuar ndryshimin e rendit të ditës dhe përfshirjen e propozimit të PD-së.

Debati u ndez gjatë fjalës së Tedi Blushit, i cili iu drejtua deputetes Aulona Bylykbashi dhe hodhi akuza për mënyrën se si janë zhvilluar konsultimet.

“Shoh që keni thirrur për konsultim aktorë të filmave të Ergys Agasit apo aleatë të bandave. Meqë kolegja Bylykbashi ka marrë përsipër të mbrojë një akt jokushtetues, dua ta pyes: kur bëtë fushatë në Cërrik e në Belsh, a u premtuat që do ua shkruini bashkitë? Kam një pyetje edhe për z. Komici, të cilin banorët e Prenjasit e përzunë nga takimi”, tha Blushi.

“Mos u merr me kolegët, dil tek procedura”, e paralajmëroi kreu i komisionit, Ulsi Manja.

Blushi vijoi duke thënë se po sillte shembuj konkretë **nga konsultimet publike**.

“Po sjell shembuj konkretë të konsultimeve publike që ju si mazhorancë keni bërë në terren. Këtu është i pranishëm kryetari i Bashkisë së Fushë-Arrëzit. Kurrë nuk ka pasur konsultime atje”, tha ai. “Vazhdo me procedurën tani. Mbylleni fjalën se i keni marrë kolegët me radhë. Ti ke orarin tani se sa është ngritur nga gjumi kryetari i partisë”, iu përgjigj Manja.

Blushi vijoi me thumba duke iu referuar Ergys Agasit dhe ish-kreut të shkarkuar të SHISG Vlorë Hysenit e vendosur në arrest shtëpie për veprat penale të përkrahjes së autorit të krimit dhe nxjerrjes së sekreteve shtetërore.

“Tani është ora që Gysi është në ajrim. Gysi ju sheh të gjithëve sot, edhe Vlorë. Është për të ardhur keq që, ndërkohë që keni propozimin e opozitës së bashkuar, do t’ju kërkoja të mos avanconi me një projekt që i ngjan tenderave të paracaktuar të Edi Ramës. Nëse Roni Yeffet do jetonte në Fushë-Arrëz, do ta kishin lënë bashki më vete. Nëse Gysi do jetonte në Memaliaj, do kishte një status special. Ta ndërpresim këtu procesin për të vlerësuar propozimin e opozitës. Në të kundërt po më ngjasoni me Vlorë Hysenin, doni t’i fikni radarët e shtetit”, tha Blushi.

Manja i tërhoqi vëmendjen për përdorimin e gjuhës dhe etiketimin e kolegëve në komision.

“Herë tjetër do të kërkoja t’i përmbaresh rregullores dhe Kodit të Etikës”, tha Manja.

Në debat ndërhyri edhe Olsi Komici, i cili hodhi poshtë pretendimin e Blushit se ishte përzënë nga një takim në Prrrenjas.

“Nuk e di çfarë librash të Andersonit ka lexuar. Nuk më kanë dëbuar nga asnjë takim që kam kryer në Bashkinë e Prrrenjasit. Do të shtyjë minutazhin në komision. Mbase dikush ia mban shënim minutat që flet. Unë jam larguar nga ai takim me dorën në qafë me të gjithë, kam shtrënguar dorën edhe me kundërshtarët. Tani të sfidoj publikisht: nxirr video”, tha Komici.

“Kam parë filmat me Gysin”, replikoi Blushi, duke insistuar në ndryshimin e rendit të ditës. Deputetët e mazhorancës kërkuar ndërkohë vazhdimin e seancës sipas rendit të ditës.

Duke iu referuar demokratëve, Manja tha: “Edhe këta do mbarojnë minutazhin e vet dhe do ikin, siç ndodhi herën e parë. Ju duhet vetëm të duroni dhe të vijojmë me rendin e ditës. Këta të vazhdojnë rrugën, ne do vazhdojmë punën”.

Në diskutim u përfshi edhe Xhelal Mziu, i cili tha se reforma territoriale ka sjellë efekte negative, pasi sipas tij paratë nuk kanë shkuar më te qytetari, ndërsa administrata jo vetëm që nuk është zvogëluar, por ka arritur në 41 mijë të punësuar. Ai gjithashtu kërkoj ndryshimin e rendit të ditës dhe diskutime për draftin demokrat.

Teksa Manja po e pyeste për çështjen procedurale, Mziu reagoi jashtë mikrofonit, duke sjellë një tjetër përplasje.

“S’më fyen dot kush mua në komision. Fyerje personale s’pranoj nga askush”, tha Manja duke mbyllur përkohësisht seancën

Në vazhdim, Manja u tha demokratëve se nisma e mazhorancës i është njoftuar seancës së parlamentit me 8 shtator dhe u është përcjellë bashkive dhe ministrive që kanë akses në këtë proces dhe është miratuar më 25 shtator në procedurën e Kuvendit.

“Nëse nisma juaj që është depozituar të premtën... po më kërkonit të shprehem për një nisëm që nuk e kam një tryezë. Kur të ndjekë procedurën parlamentare do vijë në tryezën e komisionit përgjegjës. Kërkesa juaj për ndërprerjen e kësaj mbledhjeje, duhet hedhur më votë. Nëse doni të ndryshojmë rendin e ditës e të fusim nismën tuaj unë sërish duhet ta hedh në votim” sqaroi Manja.

Debatet vijnë në një moment kur mazhoranca po avancoj me propozimin e saj për reformën e re territoriale, që parashikon kalimin nga 61 në 46 bashki. Opozita, nga ana tjetër, ka depozituar draftin e saj me 100 bashki dhe kërkon që ai të futet në diskutim, duke kundërshtuar vijimin vetëm me nismën e mazhorancës.

LAJME TË NGJASHME





Ndryshime në ligjin "Antimafia"/ Dyshime se pasuritë e sekuestruara u kthehen personave të goditur, Manja: Duhet kontroll në procesin e rishitjes

1 MIN



"Kush jemi ne të refuzojmë 4.8 miliardë euro?"/ Manja tregon projektin e ngjashëm në Britani dhe flet për Zvërnecin: Shteti serioz nuk lufton investimin, por abuzimin

6.5 MIN



Aksidenti tragjik në Durrës, Manja: Shumë shpejt në Kuvend ndryshime në Kodin Rrugor e atë Penal!

1 MIN



SPAK-u kërkon arrestimin e Ballukut, maxhoranca nuk jep OK!

1 MIN



SPAK-u kërkon arrestimin e Ballukut, Ulsi Manja prezanton raportin në grupin e PS-së!

1 MIN

MË TË LEXUARAT



Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!



"Patëm një dasmë të madhe shqiptare..."/ Dua Lipa ndan pamje nga dasma familjare!



Ben Affleck pranon se fëmijët qeshin me të kur përpiqet t'u japë këshilla për dashurinë?



Rita Ora tërheq vëmendjen me paraqitjen e fundit, vë në pah linjat trupore!



Vdekja e Giorgos Mazonakis, zbulohet mesazhi i fundit për trajtimin dhe pagesën...



"Para nga qielli"/Parashikimi i Baba Vanga-s për dy shenjat e zodiakut!



Nga dhoma e hotelit me Guardiolen te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe!



Punë e paqëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete "Made in China"!



Tanimë gjërat kanë ndryshuar/Shenjat e zodiakut që më në fund po fillojnë një kapitull të ri të jetës së tyre!

EDITORI SUGJERON



Këshilli i Sigurisë Kombëtare mbledhet urgjentisht pas rastit të Vlorë Hysenit, Muhamed Veliu jep detajet: Kush do të jetë në krye të SHISH?



Apple surprizon me risitë, AI bën gabimin e frikshëm dhe Tesla rikthen makinën që "fluturon"!



As viti i shtatë dhe as i dhjetë, ja se kur tradhtojnë çiftet në një lidhje...



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla Roadster rikthehet me një premtim të çmendur: Makina që mund të fluturojë?!



Një identifikim i gabuar nga AI ngriti në këmbë ushtrinë e SHBA-së, gati për sulm! Ja si ndodhi gjithçka...





Apple Watch tani "dëgjon" bisedat tuaja dhe i përmbledh për ju?! Risia që po ngre pikëpyetje...



Keni rënë në dashuri?! Apo është thjesht...



Apple më në fund palos iPhone-in dhe vjen me "iPhone Duo"... por a ia vlen 1,999 dollarë?



iPhone 18 Pro pas një jave përdorimi/ A ia vlen vërtet ta ndërtoni telefonin sipas Mateo Kadriut...



Do të habiteni kur të zbuloni fuqinë e kanellës!

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

[Kontakti](#)
[Marketing](#)
[Frekuencat](#)
[Aksesueshmëria](#)
[Mundësi Punësimi](#)
[Privacy Policy & Terms](#)

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.